



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO  
**GJYKATA KUSHTETUESE**  
**УСТАВНИ СУД**  
**CONSTITUTIONAL COURT**

---

Prishtinë, më 02 korrik 2012  
Nr. ref.: RK263/12

## **AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI**

në

**Rastin Nr. KI145/11**

Parashtruesi

**Shkumbin Mehmeti**

**Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjyimit të Gjykatës së Qarkut P. nr. 2003/2006 të 9 nëntorit 2007 dhe aktgjykimeve të Gjykatës Supreme AP. nr. 190/2009 të 27 janarit 2010, API. nr. 1/2010 të 26 nëntorit 2010 dhe PKL-36/11 të 10 gushtit 2011.**

### **GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS**

e përbërë nga:

Enver Hasani, Kryetar  
Kadri Kryeziu, Zëvendëskryetar  
Robert Carolan, gjyqtar  
Altay Suroy, gjyqtar  
Almira Rodrigues, gjyqtar  
Snezhana Botusharova, gjyqtare  
Ivan Čukalović, gjyqtar  
Gjylieta Mushkolaj, gjyqtare dhe  
Iliriana Islami, gjyqtare

#### **Parashtruesi i kërkesës**

1. Parashtruesi i kërkesës është z. Shkumbin Mehmeti me vendbanim në Podujevë, i përfaqësuar nga z. Teki Bokshi avokat.

### **Vendimi i kontestuar**

2. Parashtruesi i kërkesës konteston Aktgjykimin e Gjykatës së Qarkut P. nr. 2003/2006 të 9 nëntorit 2007 dhe aktgjykimet e Gjykatës Supreme AP. nr. 190/2009 të 27 janarit 2010, API. nr. 1/2010 të 26 nëntorit 2010 dhe PKL-36/11 të 10 gushtit 2011.

### **Objekti i çështjes**

3. Kërkesa e parashtruesit ka të bëjë me shkeljet e supozuara të së drejtës për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, të drejtës së të akuzuarit, si dhe të drejtës për mjete efektive juridike të Kushtetutës, lidhur me veprën penale sipas aktakuzës së ngarkuar - vrasje e rëndë dhe vrasje e rëndë në tentativë.

### **Baza juridike**

4. Neni 113.7 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta), neni 47 i Ligjit Nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, i 15 janarit 2009 (në tekstin e mëtejme: Ligji) dhe rregulli 56.2 i Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja).

### **Procedura në gjykatë**

5. Më 10 nëntor 2011, parashtruesi e dorëzoi Kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (me tutje: Gjykata).
6. Më 17 janar 2012, Kryetari, me vendimin Nr. GJR. 145/11, caktoi gjyqtarin Altay Suroy Gjyqtar Raportues. Po të njëjtën ditë, Kryetari, me vendimin Nr. KSH. 145/11, caktoi Kolegjin Shqyrtues në përbërje të gjyqtarëve: 1. Ivan Čukalović (kryesues), 2. Dr. Gjyljeta Mushkolaj (anëtare) dhe 3. Dr. Iliriana Islami (anëtare).
7. Më 18 janar 2012, Gjykata, përmes Sekretares së Përgjithshme njoftoi përfaqësuesin e parashtruesit të kërkesës dhe nga i njëjti kërkoi dokumentacion shtesë, po të njëjtën datë është njoftuar Gjykata Supreme dhe Gjykata e Qarkut në Prishtinë.
8. Më 30 janar 2012, përfaqësuesi ligjor në emër të parashtruesit dorëzoi dokumentacionin e kërkuar nga gjykata.
9. Më 8 maj 2012, Kolegji shqyrtues e shqyrtoi raportin e Gjyqtarit raportues dhe i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

### **Përmbledhje e fakteve**

10. Më 9 nëntor 2007, Gjykata e Qarkut në Prishtinë, nxori Aktgjykimin P. nr. 203/2005 me të cilin shpalli fajtor parashtruesin për veprat penale të ngarkuara: "Vrasje e rëndë", e kryer në bashkëpunim me të tjerët, "Vrasje në tentativë" dhe "Armëmbajtje pa leje". Parashtruesi për veprat penale të ngarkuara u dënua me 30 vjet burg, duke iu llogaritur koha e mbajtjes në paraburgim nga 7 prilli 2004 deri sa aktgjykimi të bëhej i formës së prerë. Kundër këtij aktgjykimi babai i parashtruesit z. Gani Mehmeti ushtroi të drejtën e ankesës në Gjykatën Supreme të Kosovës.
11. Më 27 janar 2010, Gjykata Supreme, nxori aktgjykimin AP. nr. 190/2009, dhe hodhi poshtë ankesën e babait të parashtruesit z. Gani Mehmeti, refuzoi si të pabazuar ankesën e parashtruesit, si dhe pranoi pjesërisht ankesën e avokatëve të parashtruesit, ndryshoi aktgjykimin e Gjykatës së Qarkut në Prishtinë P. nr. 203/2005 të 9 nëntorit 2007, gjegjësisht akuzat (a) dhe (b) në diapozitivin e këtij aktgjykimi janë kualifikuar si

një (1) akuzë e vrasjes së rëndë dhe vrasje e rëndë në tentativë sipas nenit 30 par. 2 pika (6) të Ligjit Penal të Kosovës (LPK) në lidhje me nenin 19 dhe 22 të Kodit Penal të RSFJ-së (KP RSFJ), dënimi i shqiptuar për të dyja akuzat është tridhjetë (30) vjet, ndërsa dënimi unik i shqiptuar për të gjitha akuzat është tridhjetë (30) vjet burgim. Gjykata Supreme, më 30 mars 2006, dënimin me dymbëdhjetë (12) vjet burgim, të shqiptuar me aktgjykimin P. nr. 126/2005 të 3 gushtit 2005 nga Gjykata e Qarkut në Pejë, e shndërroi në dënim unik prej tridhjetë (30) vjetësh burgim, paraburgimi i parashtruesit është vërtetuar nga kjo gjykatë derisa aktgjykimi të bëhej i formës së prerë me një aktvendim të veçantë. Kundër këtij aktgjykimi ishte lejuar të ushtrohet e drejta e ankesës.

12. Kundër aktgjykimit AP. nr. 190/2009 mbrojtja e parashtruesit të kërkesës, më 8 mars 2010 parashtruesi ankesë, më pas babai i parashtruesit më 18 mars 2010, si dhe vet parashtruesi më 12 prill 2010.
13. Më 26 nëntor 2010, Gjykata Supreme, nxori Aktgjykimin API. 1/2010, refuzoi si të pa bazë ankesën e 8 marsit 2010, parashtruar nga avokati i parashtruesit, hodhi poshtë si të pabazuar ankesën e 18 marsit 2010 të ushtruar nga babai i parashtruesit z. Gani Mehmeti dhe refuzoi gjithashtu ankesën e parashtruesit, ushtruar më 12 prillit 2010. Kjo gjykatë e vërtetoi aktgjykimin AP. nr. 190/2009, si të drejtë dhe në përputhje me ligjet e aplikueshme në Republikën e Kosovës.
14. Më 21 shkurt 2011, mbrojtja e parashtruesit kishte paraqitur kërkesë për mbrojtjen e ligjshmërisë kundër: aktgjykimit P. nr. 203/2005 të Gjykatës së Qarkut në Prishtinë të 9 nëntorit 2007, aktgjykimit AP. nr. 190/2009 të 27 janarit 2010 dhe API. nr. 01/2011 të 26 nëntorit 2010 të Gjykatës Supreme të Kosovës.
15. Më 5 korrik 2011, Gjykata Supreme, kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë, të paraqitur nga mbrojtja e parashtruesit të kërkesës e hodhi poshtë si të pabazuar dhe e vërtetoi aktgjykimin e Gjykatës Supreme, në përputhje me nenin 456 të KPPK. Kjo gjykatë i hodhi poshtë të gjitha pretendimet e mbrojtjes për shkelje të dispozitave esenciale të procedurës penale, duke i analizuar ato veç e veç, e njëjta erdhi në përfundim se, kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë ishte e pabazuar.

#### **Pretendimet e parashtruesit të kërkesës**

16. Parashtruesi i kërkesës pretendon se me aktgjykimin e Gjykatës së Qarkut dhe aktgjykimet e Gjykatës Supreme i janë shkelur të drejtat kushtetuese të garantuara me : Nenin 21 [Parimet e përgjithshme], Nenin 22 [Zbatimi i drejtpërdrejtë i Marrëveshjeve dhe Instrumenteve Ndërkombëtare], Neni 24 [Barazia para Ligjit], Nenin 27 [Ndalimi i Torturës, Trajtimi Mizer, Çnjerëzor ose Poshtëruar], Nenin 29 [E drejta e Lirisë dhe Sigurisë], Nenin 31 [E drejta për gjykim të drejtë dhe të paanshëm], Nenin 32 [E drejta për mjete Juridike], dhe Nenin 33 [Parimi i legalitetit dhe Proporcionalitetit në rastet Penale].
17. Ndër të tjera, parashtruesi pretendon se, gjykatat e rregullta kanë bërë shkelje të dispozitave esenciale të procedurave penale, ankohet se gjykimi ka qenë i padrejtë dhe i anshëm, ankohet se i është shkelur e drejta për mjete efektive juridike, pohon se, gjykatat nuk kanë pasur prova të drejtpërdrejta që ai i përkiste grupit të sulmuesve.

#### **Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës**

18. Në mënyrë që të jetë në gjendje të gjykojë mbi kërkesën e parashtruesit, Gjykata duhet që së pari të vlerësojë nëse parashtruesi i kërkesës i ka plotësuar kërkesat e parapara me Kushtetutë, siç specifikohen më tutje në Ligj dhe Rregullore të punës të Gjykatës.

19. Gjykata së pari duhet të përcaktojë nëse Parashtruesi është palë e autorizuar që të parashtojë kërkesë në Gjykatë, në pajtim me kërkesat e nenit 113.7 të Kushtetutës dhe 47.2 të Ligjit. Parashtruesi, ndodhet në vuajtje të dënimit dhe në emër të tij ka autorizuar përfaqësuesin e tij (avokatin) që ta përfaqësojë atë në Gjykatë. Përfaqësuesi i parashtruesit ka dorëzuar autorizimin në Gjykatë dhe ka provuar se i njëjti është palë e autorizuar në përputhje me nenin 21 të Ligjit dhe kërkesat e nenit 113.7 (Kërkesat Individuale) të Kushtetutës.
20. Gjykata, po ashtu përcakton nëse parashtruesi ka provuar t'i ketë përmbushur kërkesat e nenit 47.2 të Ligjit. Duke qenë se parashtruesi ka dorëzuar në gjykatë prova të mjaftueshme për përmbushjen e kriterit të shterimit të mjeteve efektive juridike, Gjykata, konsideron që parashtruesi i kërkesës ka përmbushur po ashtu kërkesat e nenit 113.7 të Kushtetutës, nenit 47.2 të Ligjit dhe rregullit 36.1 (a) të Rregullores së Punës.
21. Gjithashtu, parashtruesi duhet të provojë që ka përmbushur kërkesat e nenit 49 të Ligjit, sa i përket dorëzimit të kërkesës brenda afatit ligjor. Nga shkresat e lëndës vërehet qartë se vendimi i fundi për rastin e parashtruesit është aktgjykimi i Gjykatës Supreme PKL-36/11 i 5 gushtit 2011, të cilin parashtruesi e ka pranuar më 10 gusht 2011, ndërsa parashtruesi kërkesën në Gjykatë e dorëzoi më 10 nëntor 2011, që nënkupton se kërkesa është parashtruar brenda afatit 4 mujor të paraparë me ligj.
22. Gjykata, gjithashtu, përcakton nëse parashtruesi në kërkesën e tij ka saktësuar dhe qartësuar se cilat të drejta dhe liri pretendon se i jenë shkelur, më cilin akt dhe nga cila gjykatë a autoritet publik. Parashtruesi në kërkesën e tij ka përmendur shkeljet e supozuara të dispozitave Kushtetuese. Mirëpo, i njëjti duhet të argumentojë bindshëm që faktet të cilat pretendon se kanë sjellë deri te shkelja e të drejtave dhe lirive të tij të garantuara më Kushtetutë në mënyrë të pa kontestuar në thelbin e tyre përbëjnë elemente të shkeljes së ndonjë të drejte.
23. Lidhur me këtë, Gjykata, i referohet Rregullit 36.1 pikës (c) të Rregullores së Punës, që qartazi përcakton se:
 

*“(1) Gjykata mund t'i shqyrtojë kërkesat vetëm nëse:  
c) kërkesa është qartazi e bazuar.”*
24. Në rastin konkret, parashtruesi ka dështuar të provojë që shkeljet e supozuara të të drejtave kushtetuese, të përmendura në kërkesë, përbëjnë elemente të pakontestuar të shkeljes/shkeljeve të të drejtave të tij. Andaj, njeri prej kritereve të pranueshmërisë është që kërkesa e parashtruesit duhet të jetë qartazi e bazuar në mënyrë që gjykata të lëshohet në meritat e saj.
25. Gjykata, lëshohet në themelësinë e kërkesës vetëm atëherë kur konsideron që pala ka plotësuar kriteret formale dhe procedurale për procedim të mëtejme të kërkesës, prandaj nisur nga ky fakte gjykata nuk mund të lëshohet në meritat e rastit, nga shkak se, pretendimet e shkeljeve Kushtetuese dhe të Konventës për të Drejtat të Njeriut nuk përmbushin kërkesat për pranueshmërinë e kërkesë sipas nenit 46 të Ligjit dhe rregullit 36.2 (b) dhe (d) të Rregullores së Punës të Gjykatës.
26. Andaj, nuk është detyrë e Gjykatës Kushtetuese që të vlerësojë ligjshmërinë dhe saktësinë e vendimeve të dhëna nga institucionet kompetente gjyqësore, përveç nëse ka prova bindëse se vendimet e tilla janë dhënë në një mënyrë dukshëm të padrejtë dhe të paqartë.

27. Detyrë e Gjykatës, lidhur me shkeljet e supozuara të të drejtave Kushtetuese është që të analizoje dhe vlerësojë nëse procedurat, në tërësinë e tyre kanë qenë të drejta dhe në pajtueshmëri me mbrojtjen shprehimisht të përcaktuar me Kushtetutë, pra, Gjykata Kushtetuese nuk është shkallë e katërt e apelit, nuk ka juridiksion për të përsëritur procedurat gjyqësore ose t'i zëvendësojë vendimet e gjykatave të rregullta me konstatimet e veta.
28. Nuk ka prova se Gjykata e Qarkut në Prishtinë dhe Gjykata Supreme, kanë vlerësuar dhe analizuar provat të ofruara nga parashtruesi në mënyrë të pasaktë. Në të vërtetë, Parashtruesi i Kërkesës ka dështuar që të arsyetojë kërkesën e tij se Gjykatat e rregullta kanë bërë shkelje të nenit 21, 22, 24, 27, 29, 31 dhe 32 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.
29. Për shkaqet e lartcekura, Gjykata gjen se Kërkesa e Parashtruesit është haptazi e pabazuar, prandaj hidhet poshtë si e papranueshme (*shih Vendim për Papranueshmëri Lënda nr. KI 13/09, Sevdail Avdyli kundër Aktgjykimit të Gjykatës Supreme A. Nr. 533/2006 të datës 11 shtator 2006 dhe Aktgjykimit të Gjykatës Supreme A. Nr. 533/2006 të datës 2 dhjetor 2006, 17 qershor 2010*).
30. Nga sa më lartë, del se kërkesa e parashtruesit nuk i përmbushë kriteret procedurale të lejueshmërisë, siç kërkohen me nenin 46 të Ligjit, si dhe rregullin 36.2 (b) dhe (d) të Rregullores së punës, për faktin se parashtruesi ka dështuar të provojë që shkeljet e supozuara të të drejtave kushtetuese, përbëjnë arsytet e mjaftueshme në mënyrë që Gjykata të lëshohet më tutje në meritat e rastit.
31. Rrjedhimisht, kërkesa e parashtruesit të kërkesës konsiderohet e papranueshme në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, nenin 20 të Ligjit, Rregullin 56 (2) të Rregullores së Punës.


### PËR KËTO ARSYE


Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 46 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese, rregullin 36.2 (b) dhe (d) të Rregullores së punës, më 8 maj 2012, njëzëri:

### VENDOSI

- I. TA HEDHË POSHTË kërkesën si të papranueshme;
- II. Ky Vendim do t'u komunikohet palëve dhe do të botohet në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese; dhe
- III. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtar Raportues

  
Altay Suroy



Kryetar i Gjykatës Kushtetuese

  
Prof. dr. Enver Hasani